

## PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

Viti shkollor 2014/2015

# TEST I KOMBINUAR


## nga shkencat natyrore dhe shoqërore

### UDHËZIM PËR PUNË NË TEST

- Para teje është testi i kombinuar nga shkencat natyrore dhe shoqërore me detyra nga lënda e biologjisë, historisë, gjeografisë, fizikës dhe kimisë. Testin që duhesh ta zgjidhësh i ka 20 detyra, ndërsa për punë janë paraparë 120 minuta. Secilën detyrë së pari lexoje me kujdes dhe mendo se çfarë kërkohet në këtë pyetje.
- Me kujdes lexo tekstin e secilës detyre, sepse në të janë dhënë sqarime se në cilën mënyrë duhesh të përgjigjesh. Gjatë punës nuk mund të përdorësh celularin.
- Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shëno asgjë, në këtë hapësirë shënohet numri i pikëve.
- Në këte dhe faqen e fundit mos shëno asgjë.
- Testin duhesh ta plotësosh me stilolaps. Gjatë punës mund të përdorësh lapsin e thjeshtë dhe gomën. Detyrat në fillim zgjidhi me laps të thjeshtë, sepse kështu ke mundësi që, nëse e vëren gabimin, atë mund ta korrigjosh.
- Para se ta dorëzosh testin, verifikoji përgjigjet e tua, pastaj të gjitha përgjigjet shënoi me laps të thjeshtë. Përgjigjja e cila është shënuar vetëm me laps të thjeshtë nuk do të pranohet, si dhe përgjigjja e cila është e shkarravitur dhe është korrigjuar me stilolaps.
- Nëse e përfundon më herët dorëzoja testin arsimtarit kujdestar dhe qetë largohu duke mos i penguar të tjerët.

**Ju dëshirojmë sukses në provim!**

1. Trupat e elektrizuar veprojnë mes veti me forcën si në fotografi. Me cilin lloj të elektricitetit është elektrizuar trupi B?




Trupi B është i elektrizuar me elektricitete \_\_\_\_\_ .

2. Gjatë shpuarjes së vrimës në dru me turielën elektrike mund të paraqitet tym në vendin e shpimit. Pse ndodh kjo gjë?

- Ndodh për shkak të rrymës elektrike.
- Ndodh për shkak të fërkimit në mes burgisë dhe drurit.
- Ndodh vetëm nëse temperatura e ambientit ku punohet është e lartë.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

3. Në fotografi është paraqitur pishina me ujë dhe aty janë dy pika A dhe B. Në ç`raport janë presionet hidrostatike në këto dy pika?



- Presioni hidrostatik në pikën A është më i madhë, sepse gjendet në pikën më të vogël (cekët) të thellësisë.
- Presioni hidrostatik në pikën B është më i madhë, sepse gjendet në pikën më të madhe (thellë) të thellësisë.
- Presioni hidrostatik në të dyja pikat, është i njejtë, sepse që të dyja pikat qëndrojnë në të njejtën distancë nga fundi i pishinës.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

4. Trani normal ku gjatësia është 2 m ndikon forca e intenzitetit 500 N.  
Sa është forca e momentit?

Forca e momentit është \_\_\_\_\_ Nm.

5. Në vijën përballë shkruaj emrin e elementeve kimike sipas simboleve të dhënë:

a) C \_\_\_\_\_

b) Ca \_\_\_\_\_

c) Cu \_\_\_\_\_

d) Cl \_\_\_\_\_

6. Tretshmëria e disa substancave në temperaturë dhome është  $R = 204$  g. Me përzierjen e 25 g ujë dhe 51 g të substancës, në temperaturën e dhomës krijohet:

a) tretje e pangopur;

b) tretje e ngopur;

c) tretje e tejngopur.

Rretho shkronjë para përgjigjes së saktë.

7. Nitratit i natriumit  $\text{NaNO}_3$ , krijohet me reaksionin e hidroksidit të natriumit dhe:

a) oksidi i azotit (I);

b) oksidi i azotit (II);

c) oksidi i azotit (III);

d) oksidi i azotit (V).

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

8. Organizmi është njëqelizor, nuk ka zhvillim të organizuar, heterotraf dhe shumëzohet me ndarjen e qelizave. Nga ky përshkrim mund të nxjerrim një përfundim se organizmi i takon mbretërisë:

- a) monerëve;
- b) protisteve;
- c) këpurdhave;
- d) kafshëve.

Rretho përgjigjen e saktë.

9. Në pyjet tona halore dominojnë llojet e drunjëve të gjatë, si:

- a) euksliptusi;
- b) frashëri;
- c) sekuoja gjigante;
- d) dëllinja (bredhi i kuq).

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

10. Te thyerja e hapur e nëngjurit personi i lënduar duhet të:

- a) të tentojë që ashtin e thyer ta kthejë në vend;
- b) të kërkojë ndihmën e mjekut;
- c) të vejë leckën e lagur me kamomile;
- d) ta pastrojë plagën me ujë të nxehtë.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

11. Te cilat organizma **nuk mund** të vijë deri te formimi i zigotës?

- a) ameba
- b) hidra
- c) antilopa
- d) albatrosi

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

12. Hipotalamusi është pjesë:

- a) e trurit të mesëm;
- b) e trurit të madh;
- c) e trurit të vogël;
- d) e trurit të ndërmjëmë.

Rretho shkronjën paqra përgjigjes së saktë.

**13.** Pasoja e rrotullimit të Tokës rreth Diellit është:

- a) ndërrimi i ditës dhe natës;
- b) ndërrimi i stinëve të vitit;
- c) ekzistimi llogaritjeve të zonave kohore;
- d) dukja e lëvizjes ditore të Diellit.

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë.

**14.** Cili kontinent e përfaqëson anekumenën?

- a) Azinë
- b) Australinë
- c) Antarktikon
- d) Amerikën Veriore
- e) Afrikën

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë.

**15.** Secilin lum lidhe me luginat përmes së cilave ai rrjedh.

Shkruaje shkronjën përkatëse në vijën e zbrazët para emrit të lumit.

- |                             |                                       |
|-----------------------------|---------------------------------------|
| 1. _____ Morava Jugore      | a) Lugina e Zajeçarit dhe Knjazhevcit |
| 2. _____ Timoku i Bardhë    | b) Lugina e Vranjës dhe Leskovcit     |
| 3. _____ Morava Perëndimore | c) Lugina e Prijepoljes dhe Pribojit  |
|                             | d) Lugina e Pozhegës dhe Çaçakut      |

**16.** Plotësoni fjalinë.

Emri i gadishullit më të madh në Europë është \_\_\_\_\_,

dhe në raport me Serbinë gjendet në anën e \_\_\_\_\_ të botës.

**17.** Secila periudhë historike është shënuar me shkronjë.


A – periudha bashkëkohore (koha moderne)

B – koha e re (periudha e re)

C – koha e vjetër (periudha e vjetër)

D – koha e mesme (periudha e mesjetës)

Në katrorë shkruaj shkronjat përkatëse, ashtuqë periudhat historike të jenë të lidhura kronologjikisht prej më të vjetrës deri tek më e reja.



**18.** Lidhe shprehjen (nocionin) historik me sqarimin përkatës.

Shkruaje shkronjën përkatëse në vizën e zbrazët.

- |                       |   |
|-----------------------|---|
| 1. ___ Lufta e ftohtë | a) mënyra kalorsiake e luftimit në kohën e mesjetës                         |
| 2. ___ Kushtetuta     | b) shoqata e zejtarëve të të njejtit profesion                              |
| 3. ___ esnaf          | c) akti më i lartë juridik në një shtet                                     |
|                       | d) emërtimi i një periudhe në marrëdhëniet ndërkombëtare                    |
|                       | e) prona të cilën sunduesi ia ka transferuar vazalit për shërbimin e besuar |

**19.** Pas rënies mbretërisë Perëndimore të Romës Papa në vitin 800 e kurorëzoi me kurorën mbretërore një sundimtar me idenë që të vazhdohet kontinuiteti i Shtetit Romak. Kush ishte ai sundimtar?

- a) Justiniani
- b) Karli i Madh
- c) Fridrih Barbarosa
- d) Rikardi Zemërlluani

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë.

**20.** Në cilin vit doli dokumenti juridik të cilin Serbisë ia dha sulltani me pëlqimin e Ruisë dhe me atë e kufizoi sundimin e Knjaz Milloshit, e që ishte edhe një arsye për dorëheqjen e tij?

- a) viti 1829.
- b) viti 1830.
- c) viti 1833.
- d) viti 1838.

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë.